



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

NrProt.

Tiranë, më ____ . ____ . 2018

U R D H Ë R

Nr. 131, date 28. 3. 2018

PËR

**MIRATIMIN E LISTËS SË PRODUKTEVE DHE SUBSTANCAVE QË PËRDOREN NË
PRODHIMIN BIOLOGJIK¹**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, të nenit 16 pika 2, të ligjit nr. 106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”, me propozim të Drejtorisë së Prodhimit Bujqësor dhe Blegtoral,

URDHËROJ:

1. Miratimin e listës së produkteve dhe substancave që përdoren në prodhimin biologjik, bashkëlidhur këtij urdhëri.
2. Ngarkohet Minsitria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Trupat e Kontrollit dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, për zbatimin e këtij urdhëri.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare .

MINISTRI

NIKO PELESHI

¹ Ky urdhër është përafshuar pjesërisht me Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 889/2008, datë 5 Shtator 2008 që përcakton rregullat e detajuara për zbatimin e Regullores (KE) No 834/2007, “Për prodhimin biologjik dhe etiketimin e produkteve biologjike dhe që shfuqizon Rregulloren (KEE) 2092/91”, të ndryshuar.
Numri CELEX: 32008R0889, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L Nr. 250, dt. 18.9.2008, faqe. 1–84

LISTA E PRODUKTEVE DHE SUBSTANCAVE QË PËRDOREN NË PRODHIMIN BIOLOGJIK

Kjo listë përcakton produktet dhe substancat që përdoren në prodhimin biologjik sipas qëllimit të përdorimit, si mëposhtë:

1. Plehra dhe përmirësues të tokës, (përcaktuar në Aneksin I, bashkëlidhur këtij urdhëri);
2. Pesiticide – produkte për mbrojtjen e bimeve (PMB), (përcaktuar në Aneksi II, bashkëlidhur këtij urdhëri);

Të gjitha substancat e listuara në Aneksin II, duhet të plotësojnë të paktën kushtet e përcaktuara në urdhërin e ministrit nr. 72. datë 2/03/2017 “Për miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve”, i ndryshuar.

3. Produkte për pastrimin dhe dezinfektimin, e pellgjeve, kafazeve, ndërtesave dhe pajisjeve për prodhimin shtazor (përcaktuar në Aneksi III, bashkëlidhur këtij urdhëri);
4. Lëndë të para jobiologjike për ushqim për kafshë, me origjinë bimore, shtazore e minerale dhe substanca të caktuara që përdoren në ushqyerjen e kafshëve, (përcaktuar në Aneksi IV, bashkëlidhur këtij urdhëri);
5. Aditivët e ushqimit për kafshë dhe ndihmësit në përpunim, (përcaktuar në Aneksi V, bashkëlidhur këtij urdhëri).

ANEKSI I

PLEHRAT DHE PËRMIRËSUESIT E TOKËS

NUMRI	EMRI I PRODUKTIT	PËRSHKRIMI, KËRKESAT E PËRBËRJES DHE KUSHTET E PËRDORIMIT
1	Pleh i prodhuar në fermë.	Produkt që përmban përzierje të jashtëqitjeve të kafshëve dhe lëndë bimore (shtrojat e kafshëve). Ndalohen produktet me prejardhje nga fermat intensive.
2	Pleh ferme i thatë dhe pleh i dehidratuar i shpendëve.	Ndalohen produktet me prejardhje nga fermat intensive.
3	Jashtëqitjet e kafshëve të kompostuara, përfshirë plehun e shpendëve dhe plehrat e kompostuara të fermës.	Ndalohen produktet me prejardhje nga fermat intensive.
4	Jashtëqitjet e lëngshme të kafshëve.	Përdoret pas fermentimit të kontrolluar dhe/ose hollimit të përshtatshëm. Ndalohen produktet me prejardhje nga fermat intensive.
5	Përzierje të mbetjeve shtëpiake, të kompostuara ose të fermentuara.	Produkt i përfutur nga mbetjet shtëpiake të ndara në burim, të cilat i janë nënshtruar kompostimit apo fermentimit anaerobik për prodhimin e biogazit. Përdoren vetëm mbetjet shtëpiake bimore dhe shtazore, vetëm kur prodhohen në një sistem grumbullimi të mbyllur dhe të kontrolluar. Përqëndrimet maksimale të lëndës së thatë në mg/kg: kadmiumi 0.7; bakër 70; nikeli 25; plumb 45; zink 200; merkur 0.4; krom (total) 70; krom (IV) nuk dedektohet.
6	Torfë	Përdorimi i kufizuar në hortikulturë (kopshtari, lultari,

		fidanishte pyjore dhe frutore).
7	Mbetjet e kulturave kërpudhore	Përbërja fillestare e substratit të përmbajë vetëm produktet e përcaktuara në këtë Aneks.
8	Produktet e mbetjeve të kribave (kribat e kompostimit) dhe insekteve.	
9	Pleh i zogjve të egër	
10	Përzierje e mbetjeve bimore të perimeve të kompostuara ose fermentuara.	Produkti i përftuar nga përzierja e mbetjeve bimore të perimeve, të cilat i nënshtrohen kompostimit ose fermentimit anaerobik për prodhimin e biogazit.
11	Produkte që përftohen nga nënproduktet e kafshëve që përdoren për prodhimin e biogazit, të përziera me lëndë të tjera me origjinë bimore ose shtazore të përcaktuara në këtë Aneks.	Nënproduktet e kafshëve (përfshirë nën-produktet e kafshëve të egra) të kategorisë 3 dhe aparatit tretës të kategorisë 2 (kategoritë 2 dhe 3, të përcaktuara në Urdhërin e Ministrit nr. 435/1 date 30.09.2016 “Për rregullat e shëndetit në lidhje me produktet nënproduktet shtazore jo të destinuara për konsum njerëzor”. Ndalohen produktet me prejardhje nga fermat intensive. Nuk përdoren produktet bimore të konsumueshme nga njerëzit.
12	Produktet ose nënproduktet me origjinë shtazore si më poshtë: Miell gjaku Miell thundre Miell briri Miell kockash ose miell i dexhelatinuar kockash Miell peshku Miell mishi Miell puplash, qimesh Lesh Gëzof Qime Produktet e qumështit Proteina të hidrolizuara	(1) Përqendrimi maksimal në mg/kg të lëndës së thatë të kromit (VI): nuk dedektohet (0). (2) nuk lejohen të përdoren produktet bimore të konsumueshme nga njerëzit

13	Produktet dhe nënproduktet me origjinë bimore për pleh	Shembuj: mbetjet e farave vajore të përpunuara, lëvore e kakaos, gëzhutë malti.
14	Algat e detit dhe produktet e algave të detit	Nëse përftohen drejtpërdrejt nga: (i) procese fizike përfshirë dehidratimin, ngrirjen dhe bluarjen (ii) ekstraktimi me ujë ose tretësirë ujore acide dhe/ose bazike (iii) fermentimi
15	Tallash dhe ashkla druri	Druri i pa trajtuar kimikisht pas prerjes
16	Lëvore druri e kompostuar	Druri i pa trajtuar kimikisht pas prerjes
17	Hiri i drurit	Nga druri i pa trajtuar kimikisht pas prerjes
18	Fosfate nga shkëmbinj të butë	Produkti i përcaktuar në Shtojcën 1, paragrafi A.2 pika 7, të vendimit nr. 774, datë 7.11.2012 “Për rregullat, kërkesat e prodhimit, të etiketimit e të paketimit për vendosjen në treg e tolerancat dhe listën e tipave të plehrave me emërtimin "EC fertilizers". Përmbajtja e kadmiumit më e vogël se/ose e barabartë me 90 mg/kg të P ₂ O ₅ .
19	Fosfatet e alumin-kalciumit	Produkti i përcaktuar në Shtojcën 1, paragrafi A.2 pika 6, të vendimit nr. 774, datë 7.11.2012 “Për rregullat, kërkesat e prodhimit, të etiketimit e të paketimit për vendosjen në treg e tolerancat dhe listën e tipave të plehrave me emërtimin "EC fertilizers". Përmbajtja e kadmiumit më e vogël se/ose e barabartë me 90 mg/kg të P ₂ O ₅ . Përdorimi i kufizuar në toka bazike (pH > 7,5)
20	Skorje bazike :	Produkti i përcaktuar në Shtojcën 1, paragrafi A.2 pika 1, të vendimit Nr. 774, datë 7.11.2012 “Për

		rregullat, kërkesat e prodhimit, të etiketimit e të paketimit për vendosjen në treg e tolerancat dhe listën e tipave të plehrave me emërtimin "EC fertilizers".
21	Kripa të papërpunuara te kaliumit ose kainit	Produkti i përcaktuar në Shtojcën 1, paragrafi A.3 pika 1, të vendimit Nr. 774, datë 7.11.2012 "Për rregullat, kërkesat e prodhimit, të etiketimit e të paketimit për vendosjen në treg e tolerancat dhe listën e tipave të plehrave me emërtimin "EC fertilizers".
22	Sulfati i kaliumit, mundësisht të përmbajë kripë magnezi	Produkti i përfutur nga kripa e kaliumit të papërpunuar me procesin e ekstraktimit fizik, që mundësisht përmban edhe kripëra të magnezit
23	Kashta dhe ekstrakti i kashtës	përjashtuar kashtën e amonizuar
24	Karbonati i kaliumit (shkumës, argjilë, gurë gëlqeror, përmirësuesi Breton, shkumës fosfati)	Vetëm me origjinë natyrore
25	Karbonat magnezi dhe kaliumi	Vetëm me prejardhje natyrore p.sh. shkumës magnezi, mineral magnezi , gur gëlqeror
26	Sulfat magnezi	Vetëm me origjinë natyrore
27	Tretësirë e klorurit të kaliumit	Plehërim gjethor i mollës, pas identifikimit të mungesës së kaliumit
28	Sulfat kaliumi (gips)	Produkti i përcaktuar në Shtojcën 1, paragrafi D 2.2 pika 1, të vendimit Nr. 774, datë 7.11.2012 "Për rregullat, kërkesat e prodhimit, të etiketimit e të paketimit për vendosjen në treg e tolerancat dhe listën e tipave të plehrave me emërtimin "EC fertilizers". Vetëm me origjinë natyrore
29	Nënprodukte industriale nga prodhimi i sheqerit	Nënprodukt nga prodhimi i sheqerit nga panxhari i sheqerit
30	Nënprodukt industrial nga prodhimi i kripës me vakum	Nënprodukt i prodhimit të kripës së prodhuar me vakum nga uji i kripur që buron nga male

31	Squfuri i thjeshtë	Produktet e përcaktuara në Shtojcën 1, paragrafi D 2.2 pika 3, të vendimit Nr. 774, datë 7.11.2012 “Për rregullat, kërkesat e prodhimit, të etiketimit e të paketimit për vendosjen në treg e tolerancat dhe listën e tipave të plehrave me emërtimin "EC fertilizers".
32	Mikroelementet	Produktet e përcaktuara në Shtojcën 1, paragrafi E, të vendimit Nr. 774, datë 7.11.2012 “Për rregullat, kërkesat e prodhimit, të etiketimit e të paketimit për vendosjen në treg e tolerancat dhe listën e tipave të plehrave me emërtimin "EC fertilizers".
33	Klorur natriumi (kripa e gjelles)	Vetëm kripërat minerale
34	Gurë i bluar dhe argjilë	
35	Leonardite (sedimente organike të pasura me acide Humike)	Vetëm nëse përftohet si nënprodukt nga minierat.
36	Chitin (Polisakaride të përfuara nga guackat e krustaceve)	Vetëm nëse përftohet nga një peshkim i qëndrueshëm.
37	Sedimente organike të pasura nga burimet ujore të rrjedhshëm të formuara nga largimi i oksigjenit (psh Sapropel)	Vetëm sedimentet organike që janë nën - produkte të burimeve ujore të rrjedhshme të menaxhuar ose të përfuara nga burime ujore të rrjedhshme të njohura . Përftimi i tyre duhet të bëhet në mënyrë të tillë që të shkaktojë ndikim minimal në sistemin ujor. Vetëm sedimentet e përfuara nga burime të pakontaminuara nga pesticidet , ndotësit organike të qëndrueshëm dhe nënprodukte të naftës. përqendrimit maksimale të tyre në mg / kg lëndë të thatë: kadmium: 0,7; bakër: 70; nikel: 25; plumb:45; zink: 200; merkuri: 0,4; krom(total): 70; krom (VI): Nuk dedektohet

ANEKSI II

PESTICIDET — PRODUKTET PËR MBROJTJEN E BIMËVE

1. Substancat me origjinë bimore ose shtazore

Numri	Emri	Përshkrimi, kërkesat e përbërjes, kushtet e përdorimit
1	Azadirachtin e ekstraktuar nga <i>Azadirachta indica</i>	
2	Substancat bazike	Substancat bazike nuk përdoren si herbicide, por vetëm për kontrollin e dëmtuesve dhe sëmundjeve.
3	Dylli i bletëve	Përdoret vetëm për mbrojtjen pas krasitjes
4	Proteinat e hidrolizuara përjashtuar xhelatinën	
5	Laminarin	Vetëm algat e kultivuara organikisht në përputhje me ligjin nr.106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre” dhe akteve nënligjore të tij, ose të vjelura në mënyrë të qëndrueshme në përputhje me nenin 9.
6	Ferromone	Përdoret vetëm në kurthe dhe si çorientues
7	Vajrat bimore	Të gjitha përdorimet e lejuara sipas urdhërit Nr.72, datë 2/03/2017 “Për miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve”, përjashtuar përdorimin si herbicid.
8	Pyrethrins e përftuar nga <i>Chrysanthemum cinerariaefolium</i>	
9	Pyrethroids (vetëm deltamethrin ose lambda-cyhalothrin)	Vetëm në kurthe me tërheqës të veçantë; Vetëm kundër <i>Bactrocera oleae</i> dhe <i>Ceratitis capitata</i> wied.
10	Quassia e përftuar nga <i>Quassia amara</i>	Vetëm si insekticid, zbrapës

11	Zmbrapës nga aromet me origjinë bimore ose shtazore/ yndyrë delesh	Vetëm në pjesë jo të ngrënshme të kulturave bujqësore dhe këto pjesë të kulturave nuk janë ngrënë nga delet apo dhitë.
----	--	--

2. Mikroorganizmat ose substancat e prodhuara nga mikroorganizmat

Numri	Emri	Përshkrimi, kërkesat e përbërjes, kushtet e përdorimit
1	Mikroorganizma	jo me origjinë nga OMGJ –të.
2	Spinosad	

3. Substancat të tjera nga ato të përcaktuara në pikën 1 dhe 2

Numri	Emri	Përshkrimi, kërkesat e përbërjes, kushtet e përdorimit
1	Silikat alumini (kaolin)	
2	hidroksid kalciumi	Përdoret si fungicid, vetëm në pemët frutore, përfshirë fidanishtet për kontrollin e <i>Nectria galligena</i> .
3	Dyoksid karboni	
4	Komponimet e bakrit në formë:hidroksid bakri, oksiklorur bakri, oksid bakri, përzierje lëngu Bordolez, sulfat bakri trebazik.	Deri në 6 kg bakër për ha në vit. Për kulturat shumëvjeçare, kufiri prej 6 kg mund të tejkalohet në një vit të caktuar me kusht që sasia mesatare e përdorur gjatë një periudhe 5-vjeçare të përbërë nga ai vit dhe 4 vitet e mëparshme, të mos kalojë 6 kg.
5	Etilen	
6	Acidet yndyrore	Të gjitha përdorimet e lejuara sipas urdhërit Nr.72, datë 2/03/2017 “Për miratimin e lëndëve vepruese në përmbajtje të PMB-ve”, përjashtuar përdorimin si herbicid.

7	Fosfat hekuri (hekur (III) ortofosfat)	Preparate për spërkatje në sipërfaqet ndërmjet bimëve të kultivuara.
8	Kieselgur	
9	Sulfuri i gelqeres/limonit (polisulfati i kalciumit)	
10	Vaj parafine	
11	Karbonat kaliumi i hidrogjenizuar (aka bikarbonat kaliumi)	
12	Rërë kuarci	
13	Squfur	

ANEKSI III

PRODUKTET PËR PASTRIM DHE DIZINFEKTIM

1. Produktet për pastrimin dhe dezinfektimin e objekteve dhe paisjeve në prodhimin biologjik blegtoral:

- sapun kaliumi dhe natriumi
- ujë dhe avull
- qumësht gëlqere
- gelqere
- gelqere e pashuar
- Hipoklorit natriumi (p.sh. si zbardhues i lëngshëm)
- Soda kaustike
- Kaustik potash
- Peroksid hidrogjeni
- Esenca natyrale të bimëve
- Acidi citrik, peracetik, formik, laktik, oksalik dhe acetik
- Alkool
- Acidi nitrik (për pajisjet e prodhimit të bylmetit)
- Acidi fosforik (për pajisjet e prodhimit të bylmetit)
- Formaldehide
- Produktet për pastrimin dhe dezinfektimin e thithëve dhe paisjeve për mjelje
- Karbonat natriumi

2. Produktet që përdoren për pastrim dhe dezinfektim në prodhimin e specieve të akuakulturës dhe prodhimin e algave të detit.

2.1 produktet që përdoren për pastrimin dhe dezinfektimin e objekteve dhe pajisjeve kur nuk janë të pranishme në kultivim speciet e akuakulturës, mund të përmbajnë substancat aktive si mëposhtë:

- ozon
- Hipoklorit natriumi
- Hipoklorit kalciumi
- hidroksid kalciumi
- oksid kalciumi
- Sodë kaustike
- Alkool
- Sulfat bakri
- Permanganat kaliumi
- çaj farash të përftuara nga fara natyrale të camelias (përdoret vetëm në prodhimin e karkalecave)
- Përzierje e perokso-monosulfatit të kaliumit dhe klorur natriumi që prodhojnë acid hipoklorik.

1.2 Produktet që përdoren për pastrimin dhe dezinfektimin e objekteve dhe pajisjeve kur janë ose jo të pranishme në kultivim speciet e akuakulturës, mund të përmbajnë substancat aktive si mëposhtë:

- gur gëlqeror (karbonat kalciumi) për kontrollin e pH
- Dolomite për korrigjimin e pH (përdoret vetëm në prodhimin e karkalecave)
- klorur natriumi
- peroksid hidrogjeni
- Perkarbonate natriumi
- Acide organike (acid acetik, acid laktik, acid citrik)
- Acid Humik
- Acidet peroksiacetike
- acidet peracetike dhe peroktanoike
- jodofore (vetëm kur janë në fazën e vezëve)

Lëndë të para jobiologjike për ushqim për kafshë

1. Lëndë me origjinë minerale

1	Guackat gelqerore të detit
2	Maerl
3	Lithotamn
4	Glukonat kalciumi
5	Karbonat kalciumi
6	Fosfat monokalciumi i defluoruar/ Defluorinated monocalciumphosphate
7	Fosfat dikalciumi i defluoruar /Defluorinated dicalciumphosphate
8	Oksid magnezi
9	Fosfat magnezi
10	Klorur magnezi
11	Karbonat magnezi
12	Fosfati i magnezit të kalciumit CaMgO_4P^+ (Calcium magnesium phosphate)
13	Fosfat magnezi
14	fosfat mononatriumi NaH_2PO_4
15	Fosfat natrium kalciumi / Calcium sodium phosphate
16	Klorur natriumi
17	Bikarbonat natriumi
18	Karbonat natriumi
19	Sulfat natriumi
20	Klorur kaliumi

2. Substanca të tjera të ushqimit për kafshë

Fermentimi i nën-produkteve nga mikroorganizmat qelizat e të cilave janë inaktivizuar ose vrrarë:

1	Saccharomyces cerevisiae
2	Saccharomyces carlsbergiensis

ADITIVËT E USHQIMIT PËR KAFSHË QË PËRDOREN NË USHQYERJEN E KAFSHËVE

I. ADITIVET TEKNOLOGJIK

A. Konservues

	Numrat ID ose grupet funksionale	Substancat	Përshkrimi, kushtet për përdorim
1	E 200	Acid sorbik	
2	E 236	Acid formik	
3	E 237	Format natriumi HCOONa	
4	E 260	Acid acetik	
5	E 270	Acid laktik	
6	E 280	Acid propionik	
7	E 330	Acid citrik	

B. Antioksidant

	Numrat ID ose grupet funksionale	Substancat	Përshkrimi, kushtet për përdorim
1	1b306(i)	Tokoferol përftuar nga vajrat bimor	
2	1b306(ii)	Tokoferol - i pasuruar përftuar nga vajrat bimor	

C. Emulsifikues, stabilizues, trashes dhe agjentë xhelatinoz

	Numrat ID ose grupet funksionale	Substancat	Përshkrimi, kushtet për përdorim
1	E 322	Lecitin	Vetëm kur përfitohet nga lëndë e parë organike. Përdoret vetëm për ushqimin e specieve të akuakulturës.

D. Agjent lidhës jo mpiksës

	Numrat ID ose grupet funksionale	Substancat	Përshkrimi, kushtet për përdorim
1	E 535	Ferrocianite natriumi	Doza maksimale 20 mg/kg NaCl e llogaritur si anion ferrocianide.
2	E 551b	Silic koloidale	
3	E 551c	Kieselgur	
4	1m558i	Bentonite	
5	E 559	Argjila Kaolinite, pa asbest	
6	E 560	Përzierje natyrale të steariteve dhe kloriteve	
7	E 561	Vermikulite	
8	E 562	Sepiolite	
9	E 566	Natrolite-fonolite	
10	1g568	Klinoptilolite me origjinë sedimentare	
11	E 599	Perlite	

E. Aditivë të silazhit

	Numrat ID ose grupet funksionale	Substancat	Përshkrimi, kushtet për përdorim
1	1k	Enzima dhe mikroorganizma	Përdoret në prodhimin e silazhit kur kushtet e motit nuk lejojnë fermentim të përshtatshëm.

F. Aditivët shijues

	Numrat ID ose grupet funksionale	Substancat	Përshkrimi, kushtet për përdorim
1	2b	Komponime aromatizuese	Vetëm ekstrakte nga produktet bujqësore.

G. Aditivët ushqyes

a) Vitaminat, pro-vitaminat dhe substancat kimikisht të mirë përcaktuara që kanë efekt të ngjashëm

	Numrat ID ose grupet funksionale	Substancat	Përshkrimi, kushtet për përdorim
1	3a	Vitamina dhe provitamina	E përftuar nga produktet bujqësore. Nëse përfitohet sintetikisht, vetëm vitaminat që janë identike me ato që përfitohen nga produktet bujqësore mund të përdoren për kafshët monogastrike dhe kafshët e akuakulturës. Nëse përfitohen sintetikisht, vetëm vitaminat A, D dhe E që janë identike me ato që përfitohen nga produktet bujqësore mund të përdoren për ripërthypësit;

b) Komponentet e elementëve gjurmë

	Numrat ID ose grupet	Substancat
--	----------------------	------------

	funkSIONALE	
1	hekur E1	Oksid hekuri Karbonat hekuri Sulfat hekuri, Sulfat hekuri, heptahidrat Sulfat hekuri, monohidrat
2	3b201 3b202 3b203	Joduri i kaliumit Jodat kalciumi, anhidrit Jodat kalciumi anhidrit i granular dhe i veshur
3	3b301 3b302 3b303 3b304 3b305	tetrahidrat acetat kobalti (II) Karbonat kobalti (II) hidroksid karbonat kobalti(II) (2:3) monohidrate karbonat kobalti (II) I granular dhe i veshur heptahidrat sulfat kobalti (II)
4	Bakër E4 3b409	Karbonat bazik bakri, monohidrat Oksid bakri, sulfat bakri, pentahidrat trihidroksid klorur bakri II (Dicopper chloride trihydroxide (TBCC))
5	E5 Mangan	oksid mangani sulfate mangani, monohidrat karbonat mangani
6	E6 Zink 3b609	Oksid zinku Sulfat zinku, monohidrate sulfat zinku Heptahidrat hidroksid klorur zinku monohidrat (Zinc chloride hydroxide monohydrate (TBZC))

7	E7 molibdeni	Molibdat natriumi
8	E8 Selenium 3b8.10, 3b8.11, 3b8.12, 3b813 dhe 3b817	Selenium natriumi Sodium selenate/selenat natriumi Maja e selenizuar e inaktivizuar

GJ. ADITIVET ZOOTEKNIK

	Numrat ID ose grupet funksionale	Substancat
1	4a, 4b, 4c dhe 4d	Enzima dhe mikroorganizma nga kategoria e “Aditivëve zooteknik”.